



Datë: 23.07.2025
Numër Protokolli: 5031/2025

A.nr.903/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.763/2025 të datës 29.04.2025, të parashtruar nga ankuesi T.B si dhe ankesën me numër A.nr.903/2025 të datës 16.05.2025, të parashtruar nga ankuesi E.H, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.903/2025 e datës 16.05.2025, e parashtruar nga ankuesi T.B dhe ankuesi E.H.

II. Mbetët në fuqi Njoftimi me numër protokolli 679, i datës 16.04.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016418, për pozitën “Drejtor i Përgjithshëm” në Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

III. Shfuqizohet Vendimi me numër A.nr.903/2024 i datës 14.07.2025, me numër protokolli: 4725/2025, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

A r s y e t i m

Ankuesi, T.B dhe E.H (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit*), më datë 29.04.2025 respektivisht më datë 16.05.2025, kanë parashtruar ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016418, të shpallur me datë 21.01.2025 për pozitën e punës të Kategorisë së Lartë Drejtuese “Drejtor i Përgjithshëm” i Institutit të Kosovës për Administratë Publike, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.05.2025 dhe 27.05.2025 ka proceduar kërkesat për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 29.05.2025 dhe 19.06.2025, ka përcjellë përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 4011/2025, të datës 13.06.2025, ka bërë bashkimin e ankesës me numër A.nr.763/202 të datës 29.04.2025, të parashtruar nga ankuesi T.B dhe ankesën A.nr.903/2025 të datës 16.05.2025, të parashtruar nga ankuesi E.H.

Tutje, Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 4402/2025 të datës 26.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 2827/2025 të datës 29.04.2025 të parashtruar nga ankuesit T.B në Këshill; Konkursin me numër reference RN0001648 të datës 21.01.2025; Njoftimin me numër protokoli 367 të datës 06.03.2025; Njoftimin e datës 07.03.2025; Njoftimi me numër protokoli 679, të datës 16.04.2025; Kontratën e punës me numër protokoli 23 të datës 27.02.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.05.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 29.05.2025; E-mailin e datës 06.08.2024; Vendimin Nr.11/253 të datës 21.03.2025; Vendimin Nr.08/254 të datës 26.03.2025; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Formularët e datës 04.04.2025, të vlerësimit të esesë; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë të datës 15.04.2025; Pyetjet e intervistës të datës 15.04.2025; Aplikacionin e kandidatit A.T, të datës 14.02.2025, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidatit G.I të datës 06.02.2025, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidates S.S, të datës 20.02.2025, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidatit H.M, të datës 19.02.2025, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës; Aplikacionin e kandidates L.I, të datës 19.02.2025, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës; Aplikacionin e ankuesit T.B, të datës 14.02.2025, së bashku me dokumentacionin e dorëzuar për konkursin përkatës; Ankesën me numër protokoli 3219/2025 të datës 16.05.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Dokument identifikimi i ankuesit; Plotësim ankese e datës 22.05.2025; E-mailin e datës 12.07.2021; Konkursin me numër reference RN0007618 të datës 16.09.2021; Vendimin me numër protokoli 619/2022 të datës 08.04.2022; Konkursin me numër reference RN0001219 të datës 20.07.2023; Konkursin me numër reference RN00014631 të datës 06.08.2024; Njoftimin me numër protokoli 1381 të datës 08.10.2024; Njoftimin e datës 07.03.2025; Shkresë e datës 17.04.2015; Vendimin me Nr.174 të datës 08.03.2021; Përshkrimet e detyrave të punës për pozitën Drejtor Ekzekutiv i IKAP/MPB; E-mailin e datës 12.05.2025; Konkursin me numër reference RN00014646 të datës 06.08.2024; Konkursin me numër reference RN00017023; Njoftimin për pranueshmëri të datës 21.03.2025; Informimin për raportuesin e datës 19.05.2025; Vendimin me Nr.1014/2023 të datës 08.05.2023; Vendimin me Nr.1369/2023 të datës 07.11.2023; Marrëveshjen për transferim me Nr.770/2024 të datës 24.05.2025; Vendimin Nr.0313/2024 të datës 27.05.2024; Njoftimin me numër protokoli 730 të datës 04.06.2024; Konkursin me numër reference RN00013684; Vendimin me Nr.93/2025 të datës 23.01.2025; Vendimin me Nr.0030/2025 të datës 24.01.2025; E-mailin e datës 31.01.2025; Planin e trajnimeve; E-mailin e datës 26.02.2025; Vendimin me numër protokoli 1372 të datës 09.12.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.05.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 18.06.2025; Aplikacionin e ankuesit E.H, të datës 20.02.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme më datë 21.02.2025, ka shpallë Konkursin me numër reference RN00016418, për pozitën e punës të Kategorisë së Lartë Drejtuese “*Drejtor i Përgjithshëm*”, në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, me afat aplikimi nga data 22.01.2025 deri më datë 20.02.2025, ku sipas pikës 3 të këtij konkursi, kërkesa të përgjithshme formale, kanë qenë këto:

- **a) Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Administratë Publike, Shkenca Politike, Juridik, Ekonomik.

- **b) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijmë:

b.1.) pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose

b.2.) katër (4) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose

b.3.) tre (3) vite përvojë punë në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoratës).

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë njëzet e dy (22) kandidatë, ku prej tyre tetë (8) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke mos përfshirë këtu ankuesit, të cilëve Njësia për Menaxhimin e Burimeve e Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes Njoftimeve të datës 07.03.2025, i ka refuzuar aplikacionet, me arsyetimin se ankuesi T.B, nuk ka bashkangjitur dëshmitë mbështetëse të përvojës së punës si: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale. Ndërsa ankuesit E.H, i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se nuk posedon diplomën e arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor) sipas kërkesave të përgjithshme formale/kritereve të konkursit për këtë vend pune.

Tutje, sipas Njoftimit me numër protokolli 679 të datës 16.04.2025, lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, rezulton se kandidatja L.I, me gjithsejtë 88.4 pikë të arritura, kandidati H.M me gjithsejtë 82.0 pikë të arritura, kandidatja S.S me gjithsejtë 78.8 pikë të arritura si dhe kandidati G.I me gjithsejtë 72.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, janë shpallur si kandidat fitues për pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese *Drejtor i Përgjithshëm* në Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Ankuesi T.B, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit të tij nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, ngase sipas tij Oda e Farmacistëve, është institucion publik i themeluar sipas Ligjit Nr.04/L-150 për Odat e Profesionstëve Shëndetësor, rrjedhimisht i njëjti pretendon se nuk është dashur të bashkangjes dokumentet e përcaktuara nga pika 5 paragrafi 3 i konkursit, ashtu që ka kërkuar anulimin e njoftimit të datës 07.03.2025 për refuzimin e aplikacionit, anulimin e rezultateve të verifikimit paraprak të datës 07.03.2025, anulimin e rezultatit përfundimtar të datës 16.04.2025, me obligimin që Ministria e Punëve të Brendshme procesin e rekrutimit përkatës ta kthej në fazën e shqyrtimit paraprak.

Ndërsa, ankuesi E.H ka parashtruar ankesë në Këshill kundër përjashtimit nga gara dhe kudër parregullsive procedurale në konkursin përkatës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes së dispozitave ligjor dhe materiale, gjegjësisht refuzimit pa të drejtë të aplikacionit, përsëritjes së

diskriminimit, injorimit të kualifikimeve, ndryshimit jo ligjor të përshkrimit të detyrave të punës, anashkalimit të përvojës së mëparshme, konfliktit të interesit mes anëtarëve të komisionit dhe kandidatëve, favorizimeve politikeve dhe caktimit të paligjshëm të ushtruesit të detyrës ka ndikuar në mënyrë të padrejtë në procesin e konkurimit, andaj i njëjti kërkon aprovimin e ankesës si të bazuar në ligj dhe anulimin e konkursit përkatës.

Kolegji i Këshillit, gjatë afatit ligjor të vendimmarrjes, nga shkresat e bashkangjitura të ankesës së ankuesit E.H, ka gjetur se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes me e-mailit e datës 19.05.2025, kishte njoftuar ankuesin se raportimi ka kaluar në procedurë hetimore, andaj me qëllim të eliminimit të konfliktit të interesit, Këshilli më datë 04.07.2025 ishte drejtuar tek Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me kërkesën lidhur me njoftimin se a është trajtuar kërkesa e ankuesit E.H, ndërsa APK-ja me datë 11.04.2025, ka njoftuar Këshillin se kërkesa e z. E.H është në proces të shqyrtimit.

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshilli duke u bazuar në rrethanat e krijuara dhe në mbështetje të nenit 85 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit A.nr.903/2024 të datës 14.07.2025, kishte vendosur për pezullimin e procedurës lidhur me ankesën me numër A.nr.903/2025 të datës 16.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështje nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përkatësisht deri në njoftimin zyrtarë që i bëhet Këshillit nga kjo e fundit.

Ndërsa, Këshilli me datës 16.07.2025, ka pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Vendimin me numër protokolli DPKI 1221/25 të datës 16.07.2025, nga e cila rezulton se rasti DPKI-DPFQËG-0104 është mbyllur, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, rrjedhimisht pretendimi ankimor i ankuesit E.H, për konflikti të interesit mes anëtarëve të komisionit dhe kandidatëve pjesëmarrës në këtë procedurë rekrutimi është i paqëndrueshëm.

Andaj, duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore, për shqyrtimin meritore të ankesës së ankuesve, Kolegji i Këshillit, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueseve, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj*”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që*

provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Ndërsa, sipas nën pikës 3 të pikës 5 të konkursit të datës 27.01.2025, rezulton se gjithë kandidatët kanë qenë të njoftuar lidhur me dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit, ku është përcaktuar se: *Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen dhe angazhimin në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organit kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.*

Bazuar në dispozitat e lartë theksuara ligjore dhe kërkesat e përgjithshme formale të përcaktuara me shpalljen e konkursit përkatës, të cilat rezulton se janë përcaktuar në pajtim me Formularin e përshkrimit të punës për pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Kosovës për Administratë Publike, i cili është në pajtim me paragrafin 7 të nenit 21 të Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Shtojcën Nr.1/1: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Lartë, si dhe lidhur me dokumentet e kërkuara mbi dëshmimin e fushës së arsimimit dhe përvojës së punës të pasqyruara si më sipër, dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesve për mos përfshirjen e tyre në listë të ngushtë, Kolegji i Këshillit, fillimisht ka analizuar dosjen e datës 14.02.2025, të ankuesit T.B, nga rezulton se i njëjti nuk ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara sipas nën pikës 3 të pikës 5 të shpalljes së konkursit të datës 27.01.2025, gjegjësisht përvojën e tij të punës i njëjti nuk e ka mbështetur me pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale. Ndërsa, nga analizimi i dosjes së datës 20.02.2025 të ankuesit, E.H, rezulton se e njëjti posedon Diplomën me Nr.2246 të lëshuar me datë 12.09.2017, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se me datë 08.11.2000, ankuesi në fjalë ka mbaruar studimet në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Sociologjisë, si rrjedhojë ka fituar titullin Profesor i Filozofisë-Sociologjisë, nga rrjedhë se i njëjti nuk posedon kualifikimin arsimor sikurse është pasqyruar më sipër, andaj edhe pretendimet ankimore të ankuesve janë të pa bazuara, ngase të njëjti nuk kanë plotësuar kërkesat e përgjithshme formale, dhe se Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e refuzimit të aplikacioneve të ankuesve, përmes Njoftimeve të datës 07.03.2025, ka vepruar në pajtim dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht me nenin 9 paragrafin 1, nenin 47 paragrafi 5 dhe 6, ku përcaktohet se: *5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese.; si dhe me Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, gjegjësisht paragrafin 5 dhe 6 të nenit 4, dhe paragrafin 2 të nenit 6.*

Tutje, bazuar në dispozitat e lartë theksuara ligjore lidhur me plotësimin e kërkesave të përgjithshme formale apo shqyrtimin e fazës së verifikimit paraprak dhe në kontest të shqyrtimit të vlerësimit të kandidatëve nga procedura përkatëse të rekrutimit, Kolegji i Këshillit, i'u referua nenit 47 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht paragrafit 7, 8, 9, 10 dhe 11, ku përcaktohet se: *7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet*

anonimiteti i konkurrenteve/ëve si dhe intervistë me gojë. 8. Të gjithë kandidatet/ët e vlerësuar nga komisioni i pranimit mbi prapun minimal të shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë/at fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. 9. Lista e kandidatëve/ëve fitues i dërgohet mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë dhe bëhet publike nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së dhe me mjete të tjera të përshtatshme informimi. 10. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative. 11. Në rast se procedura e rekrutimit përfundon pa të paktën dy (2) kandidatë/at fitues të vlerësuar mbi prapun minimal të shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet procedurë e re rekrutimi., nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. Të gjithë kandidatët e vlerësuar nga komisioni i pranimit mbi prapun minimal të shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatët fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me vendim të arsyetuar përzgjedh kandidatin fitues të propozuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga shpallja e fituesve....; si dhe nenit 10A të Rregullores (QRK) Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve në kategorinë e lartë drejtuese pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në pesëdhjetë (50) pikë. Hartimi/përzgjedhja e pyetjeve bëhet në përputhje me paragrafin 5 të nenit 4 të kësaj Rregulloreje. 4. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzetepesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me një (1) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetepesë (25) pikë. 5. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 6. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 7. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuar nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 8. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim. 9. Komisioni i Pranimit njofton kandidatët që i janë nënshtruar testimit me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 10. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 11. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit i cili përgatit grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 12. Intervista bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti pesë (5) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 15 pikë. 13. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 14. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti pesëdhjetë (50) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 15. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si

vijon: 15.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 15.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 15.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 16. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.

Rrjedhimisht, bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni i Pranimit vlerësimin e kandidatëve në këtë procedurë rekrutimi nga faza e testit me shkrim dhe intervistës me gojë, e ka zhvilluar në pajtim me dispozitat e lartë theksuara ligjore, ndaj në shqyrtim e sipër të kësaj procedure rekrutimi Kolegji i Këshillit, ka analizuar edhe dosjen e kandidatëve fitues sipas Njoftimit me numër protokolli 679 të datës 16.04.2025, lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve, gjegjësisht dosjet e kandidatëve të cilët nga të gjitha fazat e rekrutimit kanë arritur pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, si kandidatë potencial për përzgjedhje në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike, dhe atë duke filluar sipas renditjes së kandidatëve nga pikët e arritura nga të gjitha fazat e kësaj procedure rekrutimi, rrjedhimisht nga:

- Kandidatja L.I, e cila nga faza e testit me shkrim ka arritur 42.6 pikë dhe 45.8 pikë nga intervista me gojë, duke arritur kështu gjithsejtë 88.4 pikë të përgjithshme, dhe e cila në aplikacionin e saj të datës 19.02.2025, lidhur me plotësimin e kriterit arsimor ka bashkangjitur: Diplomën me Nr.080/13 të lëshuar me datë 29.01.2013, Kolegji “Victory” në Prishtinë, me të cilën dëshmohet se e njëjta me datë 28.09.2012, ka mbaruar Studimet Themelore Universitare, në Programin Politikë Ndërkombëtare dhe Diplomaci duke fituar titullin Bachelor i Arteve për Politikë Ndërkombëtare dhe Diplomaci; dhe Diplomën me Nr.2531/14 të datës 15.12.2014, të lëshuar nga kolegji “Victory” në Prishtinë, nga i cili dokument konstatohet se kandidatja në fjalë, ka fituar gradën Master i Arteve për Politikë Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Ndërsa, sa i përket përvojës së punës profesionale dhe asaj drejtuese, e njëjta ka bashkangjitur Vërtetimin me numër protokolli 76/22-07/D të lëshuar me datë 04.03.2022, me të cilën dëshmohet se e njëjta ishte në marrëdhënie pune tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, përkatësisht nga data 01.10.2009 deri më 09.10.2013, ka qenë e angazhuar në pozitën e Përkthyesë shqip-anglisht dhe anasjelltas si dhe nga data 10.10.2013 deri më 31.03.2017, ka qenë e angazhuar në pozitën drejtuese Shefe e Zyrës së Ndihmës Shtetërore; si dhe bazuar në Akt emërimit të datës 01.12.2017, me të cilën konstatohet se e njëjta është emëruar në pozitën drejtuese Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Financave, dhe Marrëveshjen për transferimin e përhershëm për interes të institucionit me Nr.78/2025 të datës 21.01.2025, të lidhur në mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, nga rezulton se e njëjta nga pozita sipas Akt emërimit të sapo theksuar është transferuar në pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Administrimin e Dokumenteve dhe Shërbimeve në MPB, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja L.I, me anë të këtyre dokumenteve të bashkangjitura ka plotësuar të gjitha kërkesat e përgjithshme formale të lartë theksuara.

- Kandidati, H.M, nga faza e testit me shkrim ka arritur 42.2 pikë dhe 39.8 pikë nga intervista me gojë, duke arritur kështu gjithsejtë 82.0 pikë të përgjithshme, me rastin e aplikimit të tij me datë 19.02.2025, për pjesëmarrjen në procedurën e rekrutimit për këtë pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, sa i përket plotësimit të kriterit arsimor ka bashkangjitur Diplomën me Nr.907 të lëshuar me datë 02.06.2010, nga Universiteti i Prishtinës, me anë të cilit dokument dëshmohet se i njëjti me datës 30.06.2008 ka mbaruar Studimet Themelore Universitare në Fakultetin Juridik dhe ka fituar titullin Bachelor i Drejtësisë, ndërsa lidhur me plotësimin e përvojës së punës profesionale dhe asaj drejtuese, kandidati në fjalë ka bashkangjitur këto dëshmi: Vërtetimin e lëshuar nga N.T.P “Boni”-Mitrovicë, me të cilin dokument dëshmohet se i njëjti nga data 01.12.2014 deri më 30.08.2018, ka qenë i angazhuar në pozitën e Menaxherit, si dhe duke qenë se kjo përvojë pune

është jashtë institucioneve publike apo në sektorin privat, i njëjti ka bashkangjitur edhe Pasqyrën e Llogarisë së Trustit me anë të së cilit dokument vërtetohet se i njëjti i ka gjithsejtë 40 muaj kontribute të paguara tek ky punëdhënës; Vërtetimin me Nr.01-113/01-0008932/25, të lëshuar me datë 12.02.2025, nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, me anë të së cilit dokument dëshmohet se i njëjti nga data 21.12.2017 deri më 23.09.2019, ka qenë i punësuar në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, ndërsa nga data 24.09.2019 deri më 25.11.2021, në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë; si dhe Vërtetimin me numër ref: 15-37/25, të lëshuar me datë 12.02.2025 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nga i cili vërtetohet se i njëjti nga data 22.02.2022 deri më datë 14.07.2023, ka qenë i angazhuar me punë dhe detyra të Këshilltarit të Lartë Politik në Kabinetin e Ministrit, nga rrjedhë se kandidati H.M, me anë të dokumenteve të bashkangjitura ka plotësuar të gjitha kërkesat e përgjithshme formale të konkursit të datës 27.01.2025.

- Tutje, kandidatja S.S, e cila nga faza e testit me shkrim ka arritur 36.8 pikë dhe 42 pikë nga intervista me gojë, duke arritur kështu gjithsejtë 78.8 pikë të përgjithshme, me rastin e aplikimit të datës 20.02.2025, për pjesëmarrjen në procedurën e rekrutimit për këtë pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, sa i përket plotësimit të kriterit arsimor ka bashkangjitur: Diplomën me Nr.1409, të lëshuar me datë 06.04.2012, nga Universiteti i Prishtinës, me anë të cilës dëshmohet se e njëjta me datë 30.09.2011, ka mbaruar Studimet Themelore Universitare në Fakultetin Juridik, duke fituar titullin Bachelor i Drejtësisë; dhe Diplomën me Nr.981 të lëshuar me datë 19.11.2015, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën rezulton se kandidatja në fjalë ka fituar titullin Magjistër i Shkencave të Juridikut-Ndërkombëtar. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës profesionale dhe drejtuese, e njëjta ka bashkangjitur Vërtetimin për përvojën e punës me numër protokolli 2024/BNJ/400 të datës 24.12.2024, me anë të cilit dëshmohet se e njëjta nga data 01.07.2008 deri më 31.07.2013, ka qenë e angazhuar në pozitën Zyrtare e Lartë për Informim-Zëdhënës pranë Agjencisë së Statistikave të Kosovës (1 vit, 10 muaj e 2 ditë përvojë pune profesionale, pas datës 30.09.2011-diplomimit në Fakultetin Juridik); nga data 14.03.2013 deri më 31.07.2013, ka qenë e angazhuar në pozitën Zyrtare për Statistikat e Jurisprudencës në Agjencinë e Statistikave të Kosovës; nga data 01.08.2013 deri më 28.02.2016, ka qenë e angazhuar në pozitën e punës Zyrtare e Lartë për Administratë dhe Burime Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës; nga data 01.03.2016, ka qenë e angazhuar në pozitën drejtuese atë të Menaxheres së Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës; ndërsa nga data 17.07.2019, kandidatja në fjalë mban pozitën Udhëheqëse e Njesisë së Burimeve Njerëzore pranë këtij institucioni, po ashtu lidhur me këtë përvojë pune e njëjta ka bashkangjitur edhe Akt emërimit të pozitave përkatëse, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se me anë të këtyre dëshmive, kandidatja S.S ka plotësuar të gjitha kërkesat e përgjithshme formale të lartë theksuara.

- Kandidati G.I, i cili nga faza e testit me shkrim ka arritur 36.4 pikë dhe 35.8 pikë nga intervista me gojë, duke arritur kështu gjithsejtë 72.2 pikë të përgjithshme, me rastin e aplikimit të tij me datë 06.02.2025, përkitazi me kualifikimin arsimor ka bashkangjitur Diplomën me Nr.2960 të lëshuar me datë 08.02.2012 nga Universiteti i Prishtinës, me anë të cilit dokument arsimor dëshmohet se i njëjti me datë 17.05.1996, ka mbaruar Fakultetin Ekonomik dhe ka marrë kualifikimin Ekonomist i Diplomuar. Ndërsa, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës profesionale dhe drejtuese, kandidati G.I ka bashkangjitur këto dokumente: Kontratën e punës të datës 01.10.2001, të lëshuar nga UNMIK-u, me të cilën dëshmohet i njëjti nga data 01.10.2001 deri më 31.12.2002, ka qenë i angazhuar në pozitën VT-profesional; Letër emërimin e datës 06.01.2003, të lëshuar nga UNMIKU-u, për ushtrimin e pozitës Specialist për Aftësime Profesionale nga data 01.01.2003 deri më 31.12.2003; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.DPP/0829 të datës 06.02.2004, të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për pozitën Specialist për Aftësime Profesionale,

dhe atë nga data 01.01.2004 deri më 31.12.2005; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër protokolli 597/06 të lëshuar me datë 20.02.2006, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për pozitën Specialist për Aftësi Profesionale, për periudhën kohore nga data 01.01.2006 deri më 31.12.2006; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër protokolli 2135 të lëshuar me datë 12.06.2017, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për pozitën drejtuese Udhëheqës i Sektorit të Cilësisë së Trajnimeve dhe Certifikimit, për periudhën kohore nga data 01.01.2006 deri më 31.12.2007; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër protokolli 487 të lëshuar me datë 14.04.2008, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për pozitën drejtuese Udhëheqës i Sektorit të Cilësisë së Trajnimeve dhe Certifikimit, për periudhën kohore nga data 01.01.2008 deri më 31.12.2009; Kontratën e marrëdhënies së punës me numër protokolli 136 të lëshuar me datë 20.01.2010, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për pozitën drejtuese Udhëheqës i Sektorit të Cilësisë së Trajnimeve dhe Certifikimit, për periudhën kohore nga data 01.01.2010 deri më 31.12.2011; Akt emërimin me numër protokolli 438 të datës 29.02.2012, për pozitën drejtuese Udhëheqës i Sektorit të Cilësisë së Trajnimeve dhe Certifikimit, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Akt emërimin me numër protokolli 298 të datës 22.05.2014, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë i Sigurimit të Cilësisë së Trajnimit dhe Certifikimit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Akt emërimin me numër protokolli 40 të datës 30.08.2017, për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Zhvillimin e Cilësisë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës; Akt emërimin me numër protokolli 278 të datës 01.07.2019, për pozitën drejtuese Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim të Cilësisë dhe Certifikimit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës; Vendimin me numër protokolli 201 të datës 13.05.2022, përmes të cilit akt i njëjti nga pozita Udhëheqës i Divizionit për Zhvillim të Cilësisë dhe Certifikimit është caktuar zëvendësues në pozitën Drejtor i Departamentit për Aftësim Profesional; Vendimin me numër protokolli 1260 të datës 24.10.2023, me të cilin është shfuqizuar vendimi me numër protokolli 201 i datës 13.05.2022; Vendimin me numër protokolli 118 të datës 30.01.2023, me të cilin akt kandidati në fjalë është caktuar Ushtrues Detyre i Drejtorit të Departamentit për Aftësim Profesional në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit me anë të këtyre dokumenteve konstaton se kandidati G.I, ka plotësuar të gjitha kërkesat e përgjithshme formale. Andaj, duke qenë se kandidatja L.I, me gjithsejtë 88.4 pikë të arritura, kandidati H.M me gjithsejtë 82.0 pikë të arritura, kandidatja S.S me gjithsejtë 78.8 pikë të arritura si dhe kandidati G.I me gjithsejtë 72.2 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, kanë plotësuar kërkesat e përgjithshme formale, lidhur me plotësimin e kriterit të kualifikimit arsimor dhe përvojës së punës profesionale dhe drejtuese, Kolegji i Këshillit, konstaton se procedura e rekrutimit me numër reference RN00016418, konsiderohet e suksesshëm ngase e njëjta ka rezultuar me katër (4) kandidatë fitues që kanë arritur pragun minimal prej shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, rrjedhimisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e publikimit të Njoftimit me numër protokolli 679 të datës 16.04.2025, të njëjtit kandidatë me të drejtë i ka shpallur si kandidat fitues për pozitën e punës së Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, duke vepruar kështu në pajtim me paragrafin 8 të Nenit 47 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Nenin 16 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në konstatimet si me sipër se pretendimet ankimore të ankuesve janë vërtetuar si të pa bazuara dhe duke qenë se nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit me numër protokolli 679 të datës 16.04.2025, lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve të procedurës së rekrutimit me numër reference

RN00016418, për pozitën e punës së Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores (QRK) Nr.05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Andaj, theksuar si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit, vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimit me numër protokolli 679 të datës 16.04.2025, lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016418, për pozitën e punës së Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.903/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesve T.B dhe E.H;
- Udhëheqësit të Njësië për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.